



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 216, datë 25.04.2024

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...} NË PROCEDURËN E
LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 7,10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 249, datë 24.05.2023, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.05.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR